5. Partia Uniteti Kombëtar (PUK);
6. Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE);
7. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare (P.L.P.SH);
8. Partia Konservatore (KONS);
9. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ);
10. Lidhja Demokristiane Shqiptare (L.D.K);
11. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare (P.R.D.Sh).

Për 11 (njëmbëdhjetë) subjekte zgjedhore të cilat nuk dorëzuan raporte financiare për fushatën zgjedhore audituesit ligjor u shprehën si më poshtë vijon:

1. Për Partinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve audituesi ka konstatuar se ka kërkuar të vendosi komunikim zyrtar me subjektin zgjedhor për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me postë të letrës me kthim përgjigje në adresën e partisë. Kryetari i partisë ka firmosur zarfin në të cilin është informuar në lidhje me kërkesën për fillimin e procedurave të auditimit. Gjithashtu me datë 8.2.2024 është dërguar e-mail në adresën zyrtare të partisë. Gjithashtu kjo parti nuk ka dorëzuar raportin financiar për fushatë në KQZ.
2. Për Partinë Lidhja Demokristiane audituesi ka konstatuar se ka kërkuar të vendosi komunikim zyrtar me subjektin zgjedhor për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me postë të letrës, por është kthyer për shkak të adresës së pasaktë.

- Gjithashtu kjo parti nuk ka dorëzuar raport financiar për fushatën në KQZ.
3. Për Partinë Komuniste e Shqipërisë audituesi ka konstatuar se subjekti zgjedhor nuk ka bërë raportim financiar të fondeve të përfituara dhe shpenzuara për fushatë zgjedhore në KQZ, por pas komunikimit me kryetarin e partisë ky i fundit ka deklaruar se ka pasur 0 të ardhura dhe shpenzime.
  4. Për Partinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë audituesi ka konstatuar se Subjekti zgjedhor ka përpiluar raportimin financiar të fondeve të përfituara dhe shpenzuara me datë 21.2.2024 jo nëpërmjet PERF. Ky fakt nuk ka ndikim në rezultatet financiare pasi subjekti zgjedhor nuk ka pasur të ardhura dhe shpenzime.
  5. Për Partinë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane audituesi ka konstatuar se subjekti zgjedhor nuk ka përpiluar raportin financiar të fondeve të përfituara dhe shpenzuara për fushatën zgjedhore të datës 14 Maj 2023, kryetari i partisë ka deklaruar me shkrim se nuk ka pasur fonde të përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.
  6. Për Partinë Aleanca Arbnore Kombëtare audituesi ka konstatuar se subjekti zgjedhor nuk ka dorëzuar raportin financiar të fondeve të përfituara dhe shpenzuara për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023. Partia politike nuk ka dokumentacion provues për shpenzimet e kryera sipas raportit financiar të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023 për shumën 91.133 lekë.
  7. Për Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut audituesi është shprehur se partia nuk ka të shpallur në faqen zyrtare të KQZ raport financiar për fushatën zgjedhore 2023. Në këto kushte nuk mund të ketë raport auditimi për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partia politike për fushatën zgjedhore të datës 14 Maj 2023.
  8. Për Partinë Uniteti Kombëtar audituesi ligjor është shprehur se pas lidhjes së kontratës me KQZ është kërkuar të vendoset komunikim zyrtar me partinë për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me postë të letrës me kthim përgjigje. Sipas dokumentin z.Beqiri kryetar i partisë ka marrë zarfin në të cilin është informuar për fillimin e procedurave të auditimit të fushatës zgjedhore. Gjithashtu me datë 23.1.2024 është dërguar dhe një email në adresën zyrtare të partisë në të cilin është komunikuar fillimi procedurës së auditimit për subjektin zgjedhor dhe nevojën për të vënë në dispozicion informacionin për fillimin e auditimit. Të gjitha mënyrat e përdorura nuk sollën rezultate.
  9. Për Partinë Konservatore audituesi është shprehur se pas lidhjes së kontratës me KQZ është kërkuar të vendoset komunikim zyrtar me partinë për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me postë të letrës me kthim përgjigje dhe posta e ktheu për mosgjetje adrese. Gjithashtu me datë 23.1.2024 është dërguar dhe një e-mail në adresën zyrtare të partisë në të cilin është komunikuar fillimi procedurës së auditimit për subjektin zgjedhor dhe nevojën për të vënë në dispozicion informacionin për fillimin e auditimit. Të gjitha mënyrat e përdorua nuk sollën rezultate.
  10. Për Partinë Lëvizja Punëtore Shqiptare audituesi është shprehur se pas lidhjes së kontratës me KQZ është dërguar njoftim zyrtar me partinë për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet komunikimit me telefon dhe dërgimit me poste elektronike dhe fizike të letrës me kthim përgjigje, në adresën e e-mail-it dhe selisë së partisë. Nëpërmjet komunikimeve, është konfirmuar se shkresa-kërkesë për informacion është marrë nga kryetari i partisë, z. Genci Sakaj. Që nga ai moment nuk është marrë asnjë informacion

apo evidencë për çfarë i është kërkuar për të kryer auditimin. Me datë 24.4.2024 i është ridërguar një email i dytë, por nuk ka asnjë përgjigje. Gjithashtu partia nuk ka dorëzuar raport financiar për fushatë në KQZ.

11. Për Partinë e Reformave Demokratike Shqiptare audituesi është shprehur se partia nuk ka hartuar raport financiar për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore. Edhe pasi është kontaktuar me kryetarin e këtij subjekti zgjedhor, ky i fundit ka komunikuar se nuk ka asnjë shpenzim dhe për këtë arsye nuk ka depozituar raport financiar.

## 9. Rezultatet e shqyrtimit të shpenzimeve për fondet e përfituara nga buxheti i shtetit për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje

Në zbatim të nenit 88, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 397, datë 22.4.2023, “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit ë do t’u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023”, përcaktoi partitë politike përfituese të fondeve nga Buxheti i Shtetit, si dhe vlerën takuese. Nga fondet e shpërndara si paradhënie për fushatën zgjedhore, përfituan 14 (katërbëdhjetë) parti politike.

Në total Buxheti i Shtetit financoi për fushatën zgjedhore 97 064 530.08 (nëntëdhjetë e shtatë milion e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë presje tetë) lekë.

Referuar nenit 88, pika 7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet detyrimi i kthimit të diferencës në rast se shuma e dhënë si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023, është më e lartë se totali i shpenzimeve të fushatës zgjedhore të raportuara. Partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore që kanë përfituar fonde paradhënie nga Buxheti i Shtetit në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023 dhe kanë pasur më pak shpenzime sesa fondi i dhënë janë si më poshtë:

1. **“Partia Uniteti Kombëtar”** ka përfituar fonde paradhënie në vlerën 562 618.08 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë presje tetë) lekë nga Buxheti i Shtetit për fushatën zgjedhore. Nga verifikimet partia nuk ka dorëzuar raport financiar për fushatën zgjedhore, si dhe nga konstatimet e audituesit ligjor rezulton se partia politike ka marrë njoftimin për fillimin e procedurave të auditimit por nuk ka kontaktuar me audituesin. Për këtë arsye duhet të kthejë diferencën prej 562 618,08 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë presje tetë) lekë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. **“Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”** ka përfituar fonde paradhënie në vlerën 448 974.27 (katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër presje njëzet e shtatë) lekë nga Buxheti i Shtetit për fushatën zgjedhore. Nga verifikimet partia ka dorëzuar në KQZ një raport financiar për fushatën zgjedhore duke mos u përmbajtur Vendimit nr. 15, datë 7.4.2023 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore”, si dhe Vendimit nr. 458, datë 6.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për raportimin financiar në platformën elektronike të raportimin financiar (PERF) nga subjektet zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023” ku deklaroi 0 të ardhura dhe shpenzime.

Për këtë arsye duhet të kthejë diferencën prej 448 974.27 (katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër presje njëzet e shtatë) lekë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

## 10. Shqyrtimi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të raporteve financiare të dorëzuara nga vetë subjektet zgjedhore, nga monitoruesit, dhe ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor)

Nga raportet financiare të dorëzuara nga vetë subjektet zgjedhore, raportet e auditimit të ekspertëve kontabël të licensuar si dhe raportet e monitoruesve, raporte të cilat kanë qenë dhe janë publike në faqen zyrtare të KQZ, rezulton se:

1. **“Partia Socialiste e Shqipërisë”** nga verifikimet e bëra nga raportet e dorëzuara nga monitoruesit e fushatës zgjedhore rezulton se ka hapur 103 (njëqind e tre) zyra zgjedhore, ndërsa nga deklaratimet e bëra nga vetë partia në raportin financiar për fushatën zgjedhore rezulton se partia ka pasur dhurime në natyrë dhe shpenzime për 351 (treqind e pesëdhjetë e një) zyra zgjedhore, si dhe 20 (njëzet) zyra zgjedhore të deklaruara nga kandidatët për kryetar bashkie. Lidhur me reklamat politike në media partia ka deklaruar shpenzime reklamash politike në:
  - Radio Gjirokastrë vlerën 6 360 lekë;
  - TV Klan vlerën 9 714 330 lekë;
  - ABC News vlerën 6 995 608 lekë;
  - Top Channel vlerën 9 626 000 lekë;
  - Vizion Plus vlerën 4 000 000 lekë;
  - TV Klan Plus vlerën 285 670 lekë;
  - Euro Ballkan News vlerën 6 825 600 lekë;
  - Report TV (MTSC) vlerën 6 765 368 lekë;
  - Shqiptarja. Com vlerën 234 630 lekë.

Nga raportet periodike si dhe përfundimtar të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive rezulton se Partia Socialiste e Shqipërisë ka pasur reklama politike si më poshtë vijon:

- ABCnews vlerën 6 160 779 lekë;
- Euronews Albania (Euro Ballkan News) vlerën 6 546 509 lekë;
- Klan News vlerën 613 733 lekë;
- TV Klan Plus vlerën 269 943 lekë;
- TV Klan vlerën 7 243 510 lekë;
- Report TV vlerën 6 056 785 lekë;
- Top Channel vlerën 8 371 200 lekë;
- Top News vlerën 6 186 000 lekë;
- Vizion Plus vlerën 3 742 040 lekë;
- TV Kopliku vlerën 1 415 690 lekë.

Për sa më sipër rezulton se Partia Socialiste e Shqipërisë ka deklaruar më shumë shpenzime për reklama politike sesa minutazhi i deklaruar nga raportet e AMA-s në OSHMA-të si më poshtë vijon:

- TV Klan ka një diferencë në deklaram në vlerën 2 470 820 lekë;
- ABC News ka një diferencë në deklaram në vlerën 834 829 lekë;
- Top Channel ka një diferencë në deklaram në vlerën 1 254 800 lekë;
- Vizion Plus ka një diferencë në deklaram në vlerën 257 960 lekë;

- TV Klan Plus ka një diferencë në vlerën 15 727 lekë;
- Euro Ballkan News ka një diferencë në vlerën 279 091 lekë;
- ReportTv (MTSC) ka një diferencë në vlerën 708 583 lekë.

Gjithashtu ka dhe OSHMA të cilat kanë transmetuar reklama politike për Partinë Socialiste, por partia nuk i ka deklaruar në raportin e dorëzuar në KQZ, si më poshtë vijon:

- Klan News vlerën 613 733 lekë;
- Top News vlerën 6 186 000 lekë;
- TV Kopliku vlerën 1 415 690 lekë .

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dërguar shkresë partisë për sqarimin mbi reklamat politike të deklaruara nga ana e tyre.

2. **“Partia e Lirisë”** nga verifikimet e bëra nga raportet e dorëzuara nga monitoruesit e fushatës zgjedhore rezulton se ka hapur 50 (pesëdhjetë) zyra zgjedhore, ndërsa nga deklaratimet e bëra nga vetë partia në raportin financiar për fushatën zgjedhore rezulton se partia ka pasur dhurime në natyre dhe shpenzime për 16 (gjashtëmbëdhjetë) zyra zgjedhore, si dhe 26 (njëzet e gjashtë) zyra zgjedhore të deklaruara nga kandidatët për kryetar bashkie.

Lidhur me reklamat politike në media partia ka deklaruar shpenzime reklamash politike në:

- TV Sot 7 në vlerën 47 000 lekë e raportuar nga kandidati për kryetar bashkie z. Zini Tollozhina;
- Panorama TV në vlerën 222 000 lekë, e raportuar nga Kandidati për kryetar bashkie, z. Belind Këllici;
- Focus Media në vlerën 940 771 lekë, e raportuar nga Kandidati për kryetar bashkie, z. Belind Këllici;
- 3 DS & AF Entertainment (Syri TV) në vlerën 442 480 lekë, e raportuar nga Kandidati për kryetar bashkie, z. Belind Këllici;
- TV Kopliku në vlerën 12 000 lekë, e raportuar nga Kandidati për kryetar bashkie z. Isa Ramaj në;
- Focus Media në vlerën 320 220 lekë, e raportuar nga Kandidati për kryetar bashkie z. Fisnik Qosja;
- Focus Media në vlerën 55 515 lekë, e raportuar nga Kandidati për kryetar bashkie z. Erdit Hazizaj;
- Radio Gjirokastra në vlerën 3 180 lekë, e raportuar nga Kandidati për kryetar bashkie z. Dorjan Lani;
- AMG (Alternative Media Group) në vlerën 5 000 lekë, e raportuar nga Kandidati për kryetar bashkie z. Dorjan Lani.

Nga raportet periodike si dhe përfundimtar të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive rezulton se Partia e Lirisë ka pasur reklama politike si më poshtë vijon:

- ApollonTv në vlerën 87 400 lekë;
- FaxNews në vlerën 35 100 lekë;
- Klan Plus në vlerën 4 947 lekë;
- News 24 në vlerën 5 317 110 lekë;
- Syri TV në vlerën 8 203 680 lekë;
- TV Kopliku në vlerën 458 850 lekë;

Për sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dërguar shkresë Partisë.

3. **“Partia Demokratike”** nga verifikimet e bëra me raportet e monitoruesve të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për monitorimin e fushatës zgjedhore rezultojnë se ka pasur në funksion 22 (njëzet e dy) zyra zgjedhore, ndërkohë që nga verifikimet e bëra nga dorëzimi i raportit financiar për fushatë të dorëzuar në KQZ nga vetë partia rezultojnë vetëm 7 (shtatë) zyra zgjedhore.

Lidhur me reklamat politike në media partia ka deklaruar shpenzime reklamash politike në:

- StarNews RTV në vlerën 100 000 lekë;
- TV Kopliku në vlerën 50 000 lekë;
- Focus Media në vlerën 2 120 000 lekë;
- Top Channel (Ornela Islami) në vlerën 200 000 lekë;
- Ardit Bazhaku PF në vlerën 200 000 lekë.

Nga raportet periodike si dhe përfundimtar të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive rezultojnë se Partia Demokratike ka pasur reklama politike si më poshtë vijon:

- FaxNews në vlerën 650 700 lekë;
- Top Channel në vlerën 120 000 lekë;
- TV Kopliku në vlerën 20 900 lekë.

Për sa më sipër rezultojnë se Partia Demokratike ka deklaruar më shumë shpenzime për reklama politike sesa minutazhi i deklaruar nga raportet e AMA-s në OSHMA-të si më poshtë vijon:

- Top Channel ka një diferencë në deklarim në vlerën 80 000 lekë;
- TV Kopliku ka një diferencë në deklarim në vlerën 29 100 lekë;
- StarNews RTV në vlerën 100 000 lekë (sipas raporteve të AMA-s në këtë OSHMA nuk janë transmetuar reklama politike për këtë subjekt zgjedhor);
- Focus Media në vlerën 2 120 000 lekë (sipas raporteve të AMA-s në këtë OSHMA nuk janë transmetuar reklama politike për këtë subjekt zgjedhor).

Për sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dërguar shkresë Partisë.

4. **“Partia Republikane”** nga verifikimet e bëra lidhur me reklamat politike në media rezultojnë se partia ka deklaruar shpenzime reklamash politike në:

- Syri TV në vlerën 331 680 lekë;
- Ora News në vlerën 100 000 lekë;
- Top Channel në vlerën 324 000 lekë;
- TV Klan në vlerën 351 361 lekë;
- Panorama Group në vlerën 110 730 lekë;
- MTSC (Report TV) në vlerën 234 747 lekë;
- News 24 (Focus Media) në vlerën 410 808 lekë.

Nga raportet periodike si dhe përfundimtar të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive rezultojnë se Partia Republikane ka pasur reklama politike si më poshtë vijon:

- A2 CNN në vlerën 40 320 lekë;
- TV Klan në vlerën 220 963 lekë;
- News 24 në vlerën 4 964 610 lekë;
- Syri TV në vlerën 233 820 lekë;
- Top Channel në vlerën 156 000 lekë.

Për sa më sipër rezulton se Partia Republikane ka deklaruar më shumë shpenzime për reklama politike sesa minutazhi i deklaruar nga raportet e AMA-s në OSHMA-të si më poshtë vijon:

- TV Klan ka një diferencë në deklarim në vlerën 130 398 lekë;
- Syri TV ka një diferencë në deklarim në vlerën 97 860 lekë;
- Top Channel ka një diferencë në deklarim në vlerën 168 000 lekë.

Lidhur me televizionin News 24 AMA ka deklaruar se janë transmetuar 35.21 minuta reklama politike që përkojnë në vlerën 4 964 610 lekë, ndërsa vetë subjekti zgjedhor ka deklaruar vlerën 410 808 lekë, pra ka një diferencë në vlerën prej 4 553 802 lekë.

5. **“Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”** nga verifikimet e bëra me raportet e monitoruesve të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për monitorimin e fushatës zgjedhore rezulton se ka pasur në funksion 6 (gjashtë) zyra zgjedhore, ndërkohë që nga verifikimet e bëra nga dorëzimi i raportit financiar për fushatë i dorëzuar në KQZ nga vetë partia rezultojnë 18 (tetëmbëdhjetë) zyra zgjedhore. Lidhur me reklamat politike në media partia ka deklaruar shpenzime reklamash politike në:

- Focus Media (News 24) në vlerën 742 000 lekë;
- Panorma TV në vlerën 300 000 lekë;
- Report TV (MTSC) në vlerën 500 000 lekë.

Nga raportet periodike si dhe përfundimtar të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive rezulton se Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet ka pasur reklama politike si më poshtë vijon:

- News 24 në vlerën 4 404 840 lekë;
- Alpo TV në vlerën 560 lekë.

Lidhur me televizionin News 24, AMA ka deklaruar se janë transmetuar 31.24 minuta reklama politike që përkojnë në vlerën 4 404 840 lekë ndërsa vet subjekti zgjedhor ka deklaruar vlerën 742 000 lekë, pra ka një diferencë në vlerën prej 3 662 840 lekë.

Gjithashtu partia ka deklaruar pagesë dhe në televizionin Panorama TV si dhe Report TV ndërkohë që nga monitorimi i AMA-s mbi reklamat rezulton se këto televizione nuk kanë dhënë minutazh për këtë parti.

6. **“Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë”** lidhur me reklamat politike në media partia ka deklaruar shpenzime reklamash politike në:

- News 24 në vlerën 221 260 lekë.

Nga raportet periodike si dhe përfundimtar të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive rezulton se Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë ka pasur reklama politike si më poshtë vijon:

- News 24 në vlerën 761 400 lekë;



Lidhur me televizionin News 24 AMA ka deklaruar se janë transmetuar 5.4 minuta reklama politike që përkojnë në vlerën 761 400 lekë ndërsa vet subjekti zgjedhor ka deklaruar vlerën 221 260 lekë, pra ka një diferencë në vlerën prej 54 014 lekë.

7. **“Partia Konservatore”**, nga raportet periodike si dhe përfundimtar të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive rezulton se ka pasur shpenzime në televizionin TV Kopliku në vlerën 29 215 lekë ndërkohë që vet partia nuk ka deklaruar shpenzime lidhur me transmetim reklamash politike.
8. **“Partia Lëvizja Bashkë”**, nga raportet periodike si dhe përfundimtar të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive rezulton se ka pasur shpenzime në televizionin MNC në vlerën 74 921.05 lekë ndërkohë që vet partia nuk ka deklaruar shpenzime lidhur me transmetim reklamash politike.
9. **“Partia SocialDemokrate”**, nga raportet periodike si dhe përfundimtar të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive rezulton se ka pasur shpenzime në televizionin TV Kopliku në vlerën 30 765 lekë ndërkohë që vet partia nuk ka deklaruar shpenzime lidhur me transmetim reklamash politike.

### 10.1 Verifikimi i mëtejshëm me partitë politike

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Maj 2024, u kërkoi partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje, informacion mbi shpenzimet për reklamat politike për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023. Shkresa iu dërgua subjekteve zgjedhore si më poshtë vijon:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë;
2. Partia Demokratike;
3. Partia e Lirisë;
4. Lëvizja Bashkë;
5. Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë;
6. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet;
7. Partia Republikane;
8. Partia Socialdemokrate;
9. Partia Konservatore.

Subjekti zgjedhor **“Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”** ka kthyer përgjigje duke sqaruar se elementi që është transmetuar nga Focus Media News nuk ka qenë reklamë politike, por “baner”, pagesa e së cilës nuk matet me kohën e shfaqjes por me përmasat e zënies së ekranit, e cila ka një vlerë fikse të përcaktuar në kontratë. Kjo vlerë sipas nenit 4 të kontratës është në vlerën 742 000 (shtatëqind e dyzet e dy mijë) lekë.

Subjekti zgjedhor **“Partia Socialdemokrate”** ka kthyer përgjigje duke sqaruar se me OSHMA-në TV Kopliku, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë nuk ka pasur kontratë dhe nuk kanë kryer asnjë shpenzim apo pagesë në favor të kësaj OSHMA-je.

Subjekti zgjedhor **“Lëvizja Bashkë”** ka kthyer përgjigje duke sqaruar se nuk ka asnjë kontratë me OSHMA-të, si dhe nuk ka bërë asnjë pagesë në televizione për reklama politike. Të vetmet shpenzime që subjekti zgjedhor ka bërë për çështje mediatizimi në lidhje me fushatën, kanë qenë

sponsorizimet në faqet e tyre zyrtare në Facebook, sponsorizime që i kanë raportuar në raportin financiar të dorëzuar në KQZ.

Subjekti zgjedhor **“Partia e Lirisë”**, ka dërguar shkresë ku kërkon shtyrje të afatit për të kthyer përgjigje mbi shpenzimet për reklamat politike pasi i kanë nisur kërkesë OSHMA-ve për ti vënë në dispozicion kontratat që kanë lidhur me Partinë e Lirisë dhe janë ende në pritje të përgjigjeve nga ana e OSHMA-ve.

## 10.2 Verifikimi i mëtejshëm me OSHMA-të

Pas kthimit të përgjigjes nga ana e Partive Politike mbi shpenzimet për reklamat politike për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në muajin Korrik 2024 i dërgoj shkresë OSHMA-ve me lëndën kërkesë për informacion për transmetimin e reklamave politike për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023. Shkresa iu dërgua OSHMA-ve si më poshtë vijon:

1. Apollon TV;
2. Fax News;
3. Klan News;
4. Klan Plus;
5. MCN TV;
6. News 24;
7. Syri TV;
8. Top News;
9. TV Kopliku.

**“TV Apollon”** ka kthyer përgjigje duke sqaruar ka pasur një marrëveshje mes tyre dhe përfaqësuesve të Partisë së Lirisë ku është dakordësuar transmetimi i një spoti televiziv në oraret e deklaruar. Bazuar në këtë marrëveshje mes palëve është bërë edhe deklarimi përkatës në AMA, ku gjatë periudhës së monitorimit është dorëzuar edhe materiali i Partisë së Lirisë.

**“TV Klan”** ka kthyer përgjigje duke sqaruar se shoqëria TV Klan nuk ka pasur asnjë kontratë për transmetim reklamash me subjektin Partia e Lirisë” dhe në asnjërin prej kanaleve, Klan News dhe Klan Plus, nuk janë transmetuar reklama politike të këtij subjekti politik, në kuadër të zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023.

Risjellim në vëmendjen tuaj, se në lidhje me minutazhin prej 0.92 minuta në kanalën Klan Plus, nëse ky minutazh lidhet me ritransmetimin e një programi televiziv "RUDINA" me objekt aktualitet/zbavitje pjesë e secilit ka qenë z. Belind Këllici, në kuadër të intervistës në program, si pjesë ilustruese e prezantimit të jetës së tij pa qëllime reklamimi kanë qenë dhe disa pamje nga spoti. Në asnjë rast programi në fjalë nuk ka për qëllim reklamat politike në kuadër të fushatës zgjedhore. Për këtë fakt ju kemi vënë paraprakisht në dijeni dhe me shkresën tonë nr. 612/01 prot datë 12.5.2023.

Ndërsa për kanalin Klan News, meqenëse nuk na rezulton të jenë transmetuar reklama për subjektin Partia e Lirisë, nuk arrijmë të kuptojmë se nga rezulton minutazhi prej 50,89 minuta i raportuar nga AMA.

“News 24” ka kthyer përgjigje duke sqaruar se vetëm 3 nga 4 subjektet e pasqyruara në raport kanë pasur reklama politike në periudhën Maj 2023, konkretisht:

- Subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë” nuk ka pasur asnjë reklamë politike në ekranin e News 24 për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023;
- Subjekti zgjedhor “Partia Republikane” ka pasur reklamë politike në ekranin e News 24 për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023, konkretisht kontratë me vlerë 410 808 lekë;
- Subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, ka pasur reklamë politike në ekranin e News24 për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023, konkretisht kontratë me vlerë 742 000 lekë;
- Subjekti zgjedhor “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” ka pasur reklamë politike në ekranin e News 24 për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023, konkretisht me kontratë me vlerë 221 260 lekë.

### Konstatimet lidhur me kandidatët për kryetar bashkie të partive politike

Kandidatët për kryetar bashkie të Partisë Socialiste të cilët kanë pranuar dhurime me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogari bankare janë si më poshtë vijon:

1. Z. Arfi Tafani, bashkia Belsh, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 206 000 lekë;
2. Z. Armando Subashi, bashkia Fier, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 138 910 lekë;
3. Zj. Emirjana Sako, bashkia Durrës, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 75 859 lekë;
4. Z. Kreshnik Hajdari, bashkia Kuçovë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 500 000 lekë;
5. Zj. Majlinda Bufi, bashkia Roskovec, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 243 500 lekë;
6. Z. Mariglen Disha, bashkia Librazhd, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 125 490 lekë;
7. Z. Agron Malaj, bashkia Mat, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 80 000 lekë;
8. Z. Bukurosh Maci, bashkia Peqin, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 70 000 lekë.

Kandidatët për kryetar bashkie të Partisë së Lirisë të cilët kanë pranuar dhurime me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogari bankare janë si më poshtë vijon:

1. Z. Agron Loka, bashkia Krujë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 486 000 lekë;
2. Z. Albert Mëlyshi, bashkia Mirditë, ka pranuar fonde cash në vlerën 300 000 lekë;
3. Z. Ardit Cikuli, bashkia Sarandë, ka pranuar fonde cash në vlerën 259 958 lekë;
4. Z. Arjan Hoxha, bashkia Kamëz, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
5. Z. Aurel Malko, bashkia Divjakë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
6. Z. Bardh Spahia, bashkia Shkodër, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 445 280 lekë;
7. Z. Bedri Hoxha, bashki Klos, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 156 715 lekë;

8. Z. Behar Haxhiu, bashkia Kurbin, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 132 456 lekë;
9. Z. Besnik Dushaj, bashkia Tropojë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 178 758 lekë;
10. Z. Dëfrim Fiku, bashkia Bulqizë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 192 294 lekë;
11. Z. Dorjan Lani, bashkia Gjirokastrë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
12. Z. Edmond Komino, bashkia Përmet, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 198 000 lekë;
13. Z. Elvis Hajdërlli, bashkia Devoll, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 223 762 lekë;
14. Z. Et'hem Lumani, bashkia Kolonjë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 169 000 lekë;
15. Z. Evdar Kodheli, bashkia Fier, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 192 000 lekë;
16. Z. Fatmir Shero, bashkia Konispol, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 172 000 lekë;
17. Z. Fisnik Qosja, bashkia Kavajë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 392 220 lekë;
18. Z. Hasim Cekrezi, bashkia Gramsh, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 107 440 lekë;
19. Z. Hil Curri, bashkia Fushë Arrëz, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
20. Z. Hysni Sharra, bashkia Vlorë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 452 311 lekë;
21. Z. Igli Cara, bashkia Durrës, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 368 135 lekë;
22. Z. Ismail Uka, bashkia Dibër, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
23. Z. Lefter Maliqi, bashkia Kuçovë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 170 000 lekë;
24. Z. Luçiano Boçi, bashkia Elbasan, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
25. Z. Miftar Dauti, bashkia Has, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 95 948 lekë;
26. Z. Pashk Gjoni, bashkia Lezhë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 171 100 lekë;
27. Z. Resmi Shanaj, bashkia Mallakastër, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
28. Z. Shefki Cota, bashkia Librazhd, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 118 000 lekë;
29. Z. Shkëlqim Hoxha, bashkia Rrogozhinë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 316 000 lekë;
30. Zj. Sofije Alushaj, bashkia Patos, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 80 100 lekë;
31. Z. Zija Ismaili, bashkia Berat, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 105 840 lekë;
32. Z. Zini Tollozhina, bashkia Pogradec, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 188 000 lekë.

Referuar nenit 173, pika 5 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.....“Pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogari bankare, dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së”.

### **Konstatimet lidhur me kandidatët e listave shumemërore të partive politike**

Subjekti zgjedhor “Aleanca Liberale e Djathtë” në total ka regjistruar 1078 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 36 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 69 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Aleanca Arbnore Kombëtare” në total ka regjistruar 513 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 19 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian” në total ka regjistruar 15 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 1 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raportet financiare për fushatën zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane” në total ka regjistruar 106 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 5 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raportet financiare për fushatën zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet” në total ka regjistruar 356 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 15 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK” në total ka regjistruar 1393 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 47 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 12 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Ardhmërija Shqiptare” në total ka regjistruar 348 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 13 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë” në total ka regjistruar 1666 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 61 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 47 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Bindja Demokratike” në total ka regjistruar 295 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 10 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Fronti i Majtë” në total ka regjistruar 14 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 1 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Fryma e Re Demokratike” në total ka regjistruar 1063 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 37 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Lëvizja Bashkë” në total ka regjistruar 62 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 1 bashki. Nga kandidatët e regjistruar janë dorëzuar raportet financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re” në total ka regjistruar 70 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 3 bashki. Nga kandidatët e regjistruar janë dorëzuar raportet financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Lëvizja Punëtore Shqiptare” në total ka regjistruar 42 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 2 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Lidhja Demokristiane Shqiptare” në total ka regjistruar 22 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 1 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Minoriteti Etnik Grek Për Të Ardhmen” në total ka regjistruar 98 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 4 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” në total ka regjistruar 255 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 8 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 112 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Partia Agrare Ambientaliste” në total ka regjistruar 1674 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 61 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 58 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Aleanca Demokratike e Shqipërisë” në total ka regjistruar 413 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 16 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” në total ka regjistruar 416 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 16 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Balli Kombëtar” në total ka regjistruar 721 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 24 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Demokracia Sociale” në total ka regjistruar 1486 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 53 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 1369 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” në total ka regjistruar 1587 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 57 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 1440 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi, Integritet dhe Unitet” në total ka regjistruar 1465 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 53 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 44 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Partia e Gjellbër” në total ka regjistruar 678 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 25 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 583 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare” në total ka regjistruar 81 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 4 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia Emigracioni Shqiptar” në total ka regjistruar 32 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 1 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia Kombëtare Konservatore Albania” në total ka regjistruar 108 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 4 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 54 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Partia Komuniste e Shqipërisë” në total ka regjistruar 76 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 3 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia Konservatore” në total ka regjistruar 138 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 4 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia Kristian Demokrate” në total ka regjistruar 276 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 11 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja Legalitetit” në total ka regjistruar 1473 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 51 bashki. Nga të gjithë kandidatët e regjistruar janë dorëzuar raportet financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë” në total ka regjistruar 70 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 3 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë” në total ka regjistruar 144 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 5 bashki. Nga të gjithë kandidatët e regjistruar janë dorëzuar raportet financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë” në total ka regjistruar 72 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 3 bashki. Nga të gjithë kandidatët e regjistruar janë dorëzuar raportet financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” në total ka regjistruar 74 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 2 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia Republikane Shqiptare” në total ka regjistruar 1610 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 58 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 69 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate” në total ka regjistruar 1659 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 60 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 219 prej tyre.

Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në total ka regjistruar 1668 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 61 bashki. Nga të gjithë kandidatët e regjistruar janë dorëzuar raportet financiare për fushatë zgjedhore.

Subjekti zgjedhor “Partia Uniteti Kombëtar” në total janë regjistruar 360 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 13 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

### Konstatimet nga Organizata (KRIIK)

Më datë 16 Shtator 2024, Organizata Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) depozitoi nëpërmjet e-mail-it disa rekomandime lidhur me draft raportin

“Mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”.

Lidhur me konstatimet për kandidatët për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor “Koalicioni Bashkë Fitojmë”, KRIIK ka konstatuar se z. Bedri Qypi si dhe zj. Ledina Alolli kanë pranuar dhurime me vlerë më të madhe se 50 000 lekë, dhurime të cilat nuk janë bërë nëpërmjet llogarisë bankare.

KQZ, nga verifikimet e kryera pas konstatimeve të KRIIK, rezulton se kandidatët e sipërcituar kanë pranuar dhurime me vlerë më të madhe se 50 000 lekë të deklaruara në cash dhe jo nëpërmjet llogarive bankare të deklaruara në KQZ siç përcaktohet në nenin 92/2 pikat 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 20, datë 20.4.2023, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

Më konkretisht:

Z. Bedri Qypi në raportin e tij si kandidat i Koalicionit Bashkë Fitojmë i ka dhuruar vetes 81 000 lekë.

Zj. Ledina Alolli në raportin e saj si kandidate e Koalicionit Bashkë Fitojmë i ka dhuruar vetes 207 884 lekë.

Bazuar në nenin 173, pika 5 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se “.... Pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra në KQZ”.